

- 1.2. **Mjet motorik** - është mjete që lëviz në tokë me anë të fuqisë mekanike, por jo mbi shina, rimorkioja dhe gjysmë rimorkioja, të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës, për të cilat parashihet të regjistrohen dhe pajisen me dokument regjistrimi.
- 1.3. **Polica e sigurimit** - është kontrata e sigurimit nga autopërgjegjësia, respektivisht certifikata e standardizuar e sigurimit e nënshkruar nga siguroesi dhe i siguruari me të cilën provohet kontraktimi i sigurimit të autopërgjegjësisë.
- 1.4. **I siguruar** - është policëmbajtësi, interesi pasuror i të cilit është siguruar në rast përgjegjësie nga përdorimi i mjetit motorik.

Neni 3

Bonusi dhe malusi

1. Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit (vëzhgimit) ka pasur dëme të deklaruara apo jo.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, dëm i deklaruar quhet dëmi sipas të cilit është kryer pagesa ose është përcaktuar detyrimi i siguroesit (dëmi është raportuar).
3. Periudha e vëzhgimit zgjat një vit nga data e sigurimit.
4. Periudha e vëzhgimit ka filluar së zbatuari nga data 01 korrik 2012.
5. Siguroesi i pranon të siguruarit shkallën e arritur të primit në bazë të informacioneve të gjeneruara nga Qendra Informative e Sigurimeve që administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit apo informacioneve nga subjekte tjera të pranueshme për BQK-në.
6. Kur i siguruari lidh sigurimin nga autopërgjegjësia për herë të parë, paguan premin e shkallës themelore njëmbëdhjetë (11) të përcaktuar nga paragrafi 9 i këtij neni.
7. Nëse i siguruari ka qenë i siguruar të paktën një vit dhe nëse në periudhën e vëzhgimit nuk ka pasur dëme të deklaruara, të siguruarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për një shkallë më i ulët, por jo më shumë se deri në shkallën e parë (1) të përcaktuar me paragrafin 9 të këtij neni.
8. Për çdo dëm të deklaruar në periudhën e vëzhgimit pavarësisht nga kohëzgjatja e sigurimit, të siguruarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për tre (3) shkallë primi më lart, por jo më shumë se deri te shkalla e nëntëmbëdhjetë (19), ashtu siç përcaktohet me paragrafin 9 të këtij neni.
9. Shkallët e primit në përqindje që nga shkalla themelore e primit 11 (100%) janë këto:

Shkallët e BONUSIT

Shkallët e MALUSIT

1. 45%

2. 50%

12. 110%

13. 120%